



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0273**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërjen Vjosa Gradinaj Mexhuani – Kryetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) G.I.Grafo - Loni SH.P.K. kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pajisje rekuizita sportive dhe pajisje te tjera për IEAA” me numër të prokurimit 616-23-1280-1-2-1, iniciuar nga Komuna e Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK), me 11.07.2023, mori:

### **Vendim**

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE G.I.Grafo - Loni SH.P.K. e datës 15/05/2023 (Protokolli Nr. 2023/0273), kurse mbetet në fuqi Vendimi i AK i datës 25.04.2023, për dhënien e kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pajisje rekuizita sportive dhe pajisje te tjera për IEAA” me numër të prokurimit 616-23-1280-1-2-1.

2. Konfiskohet shuma e mjeteve të depozituara në emrin e tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, sikurse parashihet me 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

### **Arsyetim**

*-- Faktet dhe rrethanat procedurale --*

Me 22.02.2023, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me

pajisje rekuizita sportive dhe pajisje te tjera për IEAA” i evidentuar me numër të prokurimit 616-23-1280-1-2-1.

Me 25.04.2023, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka shpërblyer me kontratë OE Fatmir Godeni B.I.

Me 28.04.2023, OE G.I.Grafo - Loni SH.P.K, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 05.05.2023.

Me 15.05.2023, OE G.I.Grafo - Loni SH.P.K. ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 273/23, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

*Me rastin e shqyrtimit paraprak,*

Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtroj ankesë në OSHP, pas udhëheqjes së procedurës paraprake për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bie nën kompetencat e këtij organi, kuptim të nenit 105 të LPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues në OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore. Lidhur me këtë, me 23.05.2023, Ekspertit Shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me rekomandimet si në vijim:

Ankesa të refuzohet si e pabazuar

Të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin i cituar si më sipër i ekspertit shqyrtues është pranuar në mënyrë të rregull nga të gjitha palët me ç ‘rast asnjëra nga palët nuk e ka shfrytëzuar të drejtën për të paraqitur mendimin e tyre lidhur me raportin në rastin konkret. Duke ju referuar të gjitha shkresave të kësaj lënde dhe provave në dispozicion të cilat janë ofruar nga palët dhe eksperti shqyrtues i prokurimit, Paneli konsideroi se nuk ka nevojë të mbahet seanca publike me palë, meqë faktet dhe provat në dispozicion ofrojnë informacione të mjaftueshme për ta vlerësuar në mënyrë meritore çështjen në rastin konkret, konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP.

Lidhur me këtë, Paneli paraprakisht konstatoi se:

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës – furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 50,000.00 €.

Ankuesi ka pohuar se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,7,59 dhe 60 të LPP duke na eliminuar pa të drejtë ankuesin dhe duke dëmtuar buxhetin për 8,420.00 €.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Eksperti Shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues lidhur me shkeljen e dispozitave ligjore, përkatësisht me nenin 1 dhe 7 të LPP dhe 9.1 dhe 9.2 të DT-Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, janë pretendime të pa bazuara, sepse me 04.04.2023, AK, i ka dërguar ankuesit Letër Standarde për sqarimin e tenderit, me kërkesën që të bashkëngjiten referencat ose certifikatat **për kryerjen e furnizimeve**. Me 06.04.2023 ankuesi kishte bashkëngjitur në përgjigjen e dhënë, dy referenca për dy kontrata dhe fatura (sipas pagesave për furnizimet e kryera për kontrata tjera) të cilat janë prezantuar në listën e projekteve nga OE ankues në ofertë e tij. Lidhur me këtë Eksperti ka sqaruar se, kontrata me titull “Furnizimi i rekuizitave sportive dhe pajisjeve” në vlerë 45.855.00 euro, është në përputhje me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit sipas kërkesës në dosjen e tenderit. Ndërsa, kontrata me titull “Furnizim me pajisje për infografike dhe sinjalizim në objektet e komunës së Prishtinës” në vlerë 99.898.06, sipas përshkrimeve në këtë kontratë nuk i përgjigjet natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit dhe rrjedhimisht nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Ndërsa sa i përket faturave për kontratat me vlerë minimale të prezantuar nga OE ankues, sipas raportit të Ekspertit

shqyrtues konsiderohet se në dosjen e tenderit përkatësisht te **Dëshmia e kërkuar dokumentare**, AK ka kërkuar referencat ose certifikatat për kryerje e furnizimeve, andaj dorëzimi i faturave nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se shpjegimet e dhëna në raportin e ekspertizës (pa nevojë që të gjitha ato sërisht të përshkruhen dhe të komentohen) janë të arsyeshme dhe të mjaftueshme lidhur me krijimin e gjykimit në këtë rast, se ankesa nuk është e bazuar.

*- Përfundim –*

AK gjatë zbatimit të dispozitave të LPP dhe legjislacionit dytësor gjithmonë duhet të bazohet edhe në qëllimin e tij të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1, që të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuesnjëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Paneli shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në harmoni me kriteret e vendosura në dosjes së tenderit dhe se veprimet e AK janë në hermoni mes tjerash me nenin 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) dhe nenin 60 (Kriteret për Dhënien e Kontratës).

Ndonëse raporti i ekspertizës dhe rekomandimet që i përmban nuk përbejnë detyrim as për palët e as për OSHP-në, në çdo rast Panelet Shqyrtuese e vlerësojnë dhe analizojnë karakterin e tyre dokumentues, në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të një lënde dhe administrimit të provave.

Lidhur me tarifën ankimore, Paneli Shqyrtues vendosi konform nenit 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së.

Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe konform nenit 117 të LPP, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Kurse, lidhur me tarifën ankimore, është vendosur në kuptim të nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së, lidhur me nenin 118 të LPP





Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vjosa Gradinaj**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerçiale- Dhoma e shkallës së parë, departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - G.I.Grafo - Loni SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: